

DORACAK  
**SHKELJA  
E PRIVATËSISË  
DHE BULLIZMI  
NË INTERNET**



**MYLA**

**ABA**  
AMERICAN BAR ASSOCIATION  
Rule of Law Initiative

DORACAК:  
**SHKELJA E PRIVATËSISË DHE BULLIZMI  
NË INTERNET – SI TË MBROHESH?**

Shkup, 2022

**Наслов на оригиналот:** ПРИРАЧНИК: ПОВРЕДА НА ПРИВАТНОСТА И  
ВРСНИЧКО НАСИЛСТВО НА ИНТЕРНЕТ – КАКО ДА СЕ ЗАШТИТИШ?

**Botues:** Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (ShMJR)  
rr. "Donbas" nr. 14/1-6 1000 Shkup  
[www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk) | [contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk)  
tel. 02/ 3220 870

**Autorë:** Maja Atanasova | Arben Gudaçi

**Redaktor:** Martina Drangovska Martinova

**Përkthimi nga gjuha maqedonase:** Abakus

**Dizajni:** Brigada dizajn

**Shtypja:** Art print studio

**Tirazhi:** 250 ekzemplarë

CIP – Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје  
342.738:004.738.5(035)  
364.636-053.6:004.738.5(035)  
316.624-053.6:004.738.5(035)

DORACAК : abuzimi i të dhënave personale dhe bullizmi në internet si të mbrohesh?  
/ [Maja Atanasova, Arben Gudaçi]. – Shkup : Shoqata Maqedonase e Juristëve të  
Rinj, 2022. – 16 стр. : илустр. ; 15 см

Библиографија стр. 17

ISBN 978-608-4843-63-4

1. Atanasova, Maja [автор] 2. Gudaç, Arben [автор]

а) Лични податоци – Злоупотреба – Интернет – Прирачници б) Врсничко  
насилство – Интернет – Заштита – Прирачници

COBISS.MK-ID 57406725



**MYLA**



Deklaratat dhe analizat e përfshira në këtë analizë janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk janë të miratuara nga Dhoma e Deleatëve ose nga Bordi i Guvernatorëve të Shoqatës së Avokatëve Amerikanë, as nga Iniciativa për Sundimin e Ligjit të Shoqatës së Avokatëve Amerikanë dhe as nuk përfaqësojnë pozitën apo politika e Shoqatës së Avokatëve Amerikanë / Iniciativës për Sundimin e Ligjit. Asgjë në këtë manual nuk duhet të interpretohet si ofrim i këshillave ligjore për raste specifike. Përmbajtja është përgjegjësi e Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit ose të ABA/ABA ROLI.

# Përmbajtja

<b>Hyrje .....</b>	<b>5</b>
--------------------	----------

## **I SHKELJA E PRIVATËSISË NË INTERNET .....**

1. Çfarë janë të dhënat personale? .....	7
2. Çfarë është përpunimi i të dhënave personale? .....	7
3. A kam të drejtë të kërkoj që të dhënat e mia personale të fshihen/shkatërrohen nëse i kam ndarë ose dhënë tashmë? .....	8
4. Nëse jam në një ngjarje publike (koncert, kinema, protestë, etj.) a mund të ndaloj përdorimin e një fotografie dhe/ose regjistrimi ku unë dukem? .....	8
5. A nevojitet pëlqimi im që dikush të ndajë foton time në internet? .....	9
6. A kam të drejtë të ndaj një fotografi të bërë me telefonin tim, në profilin tim të rrjetit social me persona të tjerë në të, pa pëlqimin e tyre? .....	9
7. A është shkelja e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, bërja e një fotografie nga një profili të mbyllur dhe publikimi i saj dhe/ose ndarja e saj me persona të tjerë? .....	9
8. A mund të raportoj dhunë në familje ose bashkëmoshatarët te një mësues i klasës, drejtor ose mësues tjetër pa dhënë pëlqimin e viktimës? ....	10
9. Ku mund të raportoj raste të shkeljes së privatësisë.....	10

## **II BULLIZMI NË INTERNET ..... 11**

1. Çfarë është bullizmi (dhuna ndërmjet moshatarëve)? .....11
2. A kryej bullizëm nëse ndaj gënjeshtra ose foto/video të turpshme të shokut të klasës në rrjetet sociale? .....11
3. Si të parandaloj që të dhënat e mia personale të përdoren për të më manipuluar ose poshtëruar në mediat sociale?.....12
4. Mendoj se jam viktimë e bullizmit, por nuk jam i/e sigurt. Si mund ta di nëse ky është rasti? .....12
5. A është bullizëm nëse .....13
6. Ku mund të drejtohem për mbështetje dhe ndihmë në rast të bullizmit? .....14
7. Çfarë mund të bëj nëse jam dëshmitar i bullizmit? .....14

## **III SI TË MBROHEM? ..... 15**

Disa këshilla se si të mbrosh informacionin tënd personal..... 15

Çfarë mund të bësh për të reduktuar rrezikun e bullizmit në internet? ..... 16

## **Burime .....17**

## Hyrje

Jetojmë në një epokë informacioni dhe përparimet në teknologji kanë mundësuar ndërveprim më të shpejtë dhe më të lehtë në distancë nëpërmjet platformave sociale. Megjithatë, qarkullimi i lirë i informacionit dhe përdorimi masiv i mediave sociale na ekspozon ndaj rreziqeve të ndryshme, si abuzimi i të dhënave personale dhe bullizmi. Edhe pse ato kanë ndodhur edhe para ardhjes së internetit dhe vazhdojnë të jenë të pranishme dhe “offline”, me përdorimin e internetit, abuzimi i të dhënave personale dhe bullizmi marrin forma dhe hapësirë të re. Kjo nuk do të thotë që duhet të shmangim rrjetet e preferuara sociale dhe të “shkëputemi” plotësisht nga komunikimi në internet. Por është e rëndësishme të jemi mirë të informuar për rreziqet e mundshme mënyrat për t’i shmangur ato.

Doracaku është përgatitur nga Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (ShMJR) dhe është dedikuar kryesisht nxënësve të shkollave të mesme, por mund të jetë i dobishëm edhe për prindërit/kujdestarët e tyre, mësuesit dhe punonjësit socialë, si dhe profesionistët të tjerë që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Doracaku përbëhet prej tre pjesëve:

- I. SHKELJA E PRIVATËSISË NË INTERNET** – kjo pjesë sqaron se çfarë nënkuptohet me të dhëna personale dhe përpunimin e të dhënave personale dhe jep shembuj specifike për t’iu përgjigjur pyetjeve se çfarë është shkelja e privatësisë dhe ku duhet raportuar.
- II. BULLIZMI NË INTERNET** – kjo pjesë trajton dhunën e bashkëmoshatarëve, e njohur më mirë si bullizëm, me theks të veçantë mbi bullizmin kibernetik. Këtu do flitet për njohjen e bullizmit në situata specifike dhe se çfarë mund të bëhet në një rast të tillë.
- III. SI TË MBROHEM?** – pjesa e tretë përmban disa këshilla që mund të zbatohen për të reduktuar rrezikun e shkeljes së privatësisë dhe bullizmit në internet.

Nëse ke pyetje rreth kësaj teme, mos hezito të kontaktosh Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj (ShMJR) në 02-3220-870 ose [contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk).

# I.

## SHKELJA E PRIVATËSISË NË INTERNET

### 1. Çfarë janë të dhënat personale?

Të dhënat personale janë emri, mbiemri, numri amë, adresa e shtëpisë, posta elektronike, numri i telefonit, numri i kartës së kreditit, informacioni i vendndodhjes tuaj, adresa IP, zakonet e konsumatorit, etj. Me pak fjalë, e dhënë personale mund të jetë çdo informacion që lidhet me ty ose nëpërmjet të cilit ti mund të identifikohesh, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Kategoritë e veçanta të të dhënave personale janë të dhëna personale që zbulojnë origjinën racore ose etnike, pikëpamjet politike, besimet fetare ose filozofike ose anëtarësim në sindikata, si dhe të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat shëndetësore ose të dhëna për jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi.

### 2. Çfarë është përpunimi i të dhënave personale?

Përpunimi i të dhënave tuaja personale mund të jetë çdo aktivitet që kryhet mbi të dhënat tua personale - nga mbledhja e tyre deri në fshirjen ose shkatërrimin e tyre. Për shembull, kur merr pjesë në një lojë shpërblyese, hap kartë klubi për lirime ose llogari në rrjetin social, ti jep pëlqim për përpunimin e të dhënave tua. Institucionet ose kompanitë që përpunojnë të dhëna quhen kontrollues.

### **3. A kam të drejtë të kërkoj që të dhënat e mia personale të fshihen/shkatërrohen nëse i kam ndarë ose dhënë tashmë?**

Pavarësisht nëse vet i ke ndarë të dhënat tua personale ose ato janë ndarë nga një palë e tretë, ke të drejtë të kërkoj që ato të fshihen ose shkatërrohen. Nëse informacioni personal ndahet me pëlqimin tënd, mund ta tërheqësh pëlqimin tënd në mënyrë që ai të fshihet. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute, sepse në disa raste ekziston detyrim ligjor për të ruajtur të dhënat, kështu që ato nuk mund të fshihen (për shembull, të dhënat në dosjen tënde të shkollës).

### **4. Nëse jam në një ngjarje publike (koncert, kinema, protestë, etj.) a mund të ndaloj përdorimin e një fotografie dhe/ose regjistrimi ku unë dukem?**

Në vendet ku mbahen ngjarje publike, niveli i privatësisë që e kemi është ulur. Në ngjarje publike, zakonisht në hyrje, ka njoftim se ngjarja është duke u regjistruar dhe se një pjesë ose e gjitha e ngjarjes mund të jetë publikisht në dispozicion për të gjithë. Kjo do të thotë se me vetë praninë tënde ti ke dhënë pëlqimin për të përdorur fotot ose regjistrimet tua të ngjarjes. Në këtë rast, mund të kërkoj që fotografia jote të fshihet vetëm nëse është e papërshtatshme për qëllimin për të cilin është bërë.



## **5. A nevojitet pëlqimi im që dikush të ndajë foton time në internet?**

Po, çdo herë që dikush shpërndan foton tënde, ai është i detyruar të sigurojë pëlqimin tënd. Përndryshe, ti ke të drejtë të kërkoesh që ajo të fshihet. Pëlqimi nuk duhet të jetë gjithmonë me shkrim, veçanërisht nëse fotografia shpërndahet nga miq ose anëtarë të familjes tënde. Në këtë rast, pëlqimi verbal është i mjaftueshëm. Megjithatë, kur bëhet fjalë fëmijë, dhe fotografia shpërndahet nga shkolla ose një person tjetër juridik, kërkohet pëlqimi me shkrim nga prindërit/kujdestarët tuaj.

## **6. A kam të drejtë të ndaj një fotografi të bërë me telefonin tim, në profilin tim të rrjetit social me persona të tjerë në të, pa pëlqimin e tyre?**

Çdo herë që ka njerëz të tjerë në foto, ata duhet të informohen dhe të japin pëlqim përpara se ajo të publikohet, pavarësisht nëse fotografia është marrë nga telefoni yt.

## **7. A është shkelja e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, bërja e një fotografie nga një profili të mbyllur dhe publikimi i saj dhe/ose ndarja e saj me persona të tjerë?**

Po, çdo përpunim i të dhënave personale jashtë qëllimeve për të cilat ato janë publikuar është shkelje e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Nuk lejohet shkarkimi, pra realizimi i shtypjes së fotove nga profilet e të tjerëve, pavarësisht nëse është profil i hapur apo i mbyllur. Kjo nuk vlen për situatat kur ndani njoftim publik të autorit në mënyrë që ai të arrijë më shumë njerëz.

## **8. A mund të raportoj dhunë në familje ose bashkëmoshatarët te një mësues i klasës, drejtor ose mësues tjetër pa dhënë pëlqimin e viktimës?**

Në rast të dhunës në familje ose të bashkëmoshatarëve, është përgjegjësia jote që t'i raportosh mësuesit të klasës, pedagogut ose një personi tjetër kompetent në shkollë, në mënyrë që nxënësi të marrë mbrojtjen e duhur. Drejtori i shkollës është i obliguar t'u raportojë organeve kompetente përkatëse, të cilat më tutje ndërmarrin aktivitetet e duhura. Në këtë rast nuk kërkohet pëlqimi i viktimës sepse në radhë të parë është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.

## **9. Ku mund të raportoj raste të shkeljes së privatësisë?**

Nëse mendon se e drejta jote për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur, mund t'i dorëzosh kërkesë Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDhP) në faqen e tyre të internetit [www.dzlp.mk](http://www.dzlp.mk). Për këtë qëllim, në kërkesë duhet të deklarosh të dhënat tua personale dhe të dhënat e kontrollorit i cili sipas teje ka shkelur të drejtën tënde për mbrojtjen e të dhënave personale.

## II. BULLIZMI NË INTERNET

### 1. Çfarë është bullizmi (dhuna ndërmjet moshatarëve)?

Bullizmi ose dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve është një formë sjelljeje që zgjat shumë kohë, përsëritet dhe i drejtohet të njëjtit person. Është veprim i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm, me qëllim të lëndimit ose frikësimit të tjetrit, ku autori ka më shumë pushtet ose ndikim në shoqërinë e viktimës. Bullizmi mund të marrë formën e fyerjeve, talljeve, shpifjeve, thashethemeve, përhapjes së gënjeshtreve dhe thashethemeve, dhunës fizike, kërcënimeve dhe të ngjashme. Mund të ndodhë në jetën reale dhe në internet, pra në rrjetet sociale, platforma të mesazheve apo lojëra, etj.(bullizëm–kibernetik).

### 2. A kryej bullizëm nëse ndaj gënjeshtre ose foto/video të turpshme të shokut të klasës në rrjetet sociale?

Po, ky është një shembull i bullizmit kibernetik, i cili gjithashtu mund të marrë formën e dërgimit të mesazheve, fotove dhe videove fyese ose kërcënuese përmes platformave të mesazheve. Gjithashtu, të pozuarit si dikush tjetër për të dërguar mesazhe keqdashëse në emër të tij/saj përmes profileve të rreme është bullizëm kibernetik.

### **3. Si të parandaloj që të dhënat e mia personale të përdoren për të më manipuluar ose poshtëruar në mediat sociale?**

Mendo dy herë përpara se të ndash diçka në platformat digjitale - mund të mbetet përgjithmonë online dhe të përdoret më vonë për të t'ë lënduar. Mos ndaj të dhënat personale, si adresa e shtëpisë, numri i telefonit ose emri i shkollës. Mëso rreth cilësimeve të privatësisë së rrjeteve sociale që përdor dhe përdor veçori si: kush mund ta shikojë profilin tuaj, të raportojë mesazhe dhe profile dhe të bllokojë njerëz.

### **4. Mendoj se jam viktimë e bullizmit, por nuk jam i/e sigurt. Si mund ta di nëse ky është rasti??**

Të gjitha situatat ku fëmijët dhe të rinjtë përfshihen në konflikt nuk mund të kuptohen si bullizëm. Është më mirë të pyesni veten: A ka për qëllim sjellja e tij/saj t'ju lëndojë? A po ndodh ende? A është fjala për pushtet - a është ai/ajo më i/e vjetër, më i/e fortë apo më me ndikim se ti? Nëse i je përgjigjur "PO" të tre pyetjeve, ka shumë të ngjarë që të jetë bullizëm.

## 5. A është bullizëm nëse...

<p>...jam pjesë e një grupi në internet që tallet ose nënçmon një person tjetër që nuk është anëtar i grupit?</p>	<p>Nëse tallja ose poshtërimi ndodh me qëllim që të lëndohet ose ofendohet personi dhe kjo ka pasoja për të në realitet, është bullizëm...</p>
<p>...publikoj dhe/ose ndaj biseda ose pjesë të bisedave që më janë besuar personalisht?</p>	<p>Nëse bisedat e përbashkëta kanë për qëllim të lëndojnë një person, atëherë është bullizëm. Ndryshe, mund të bëhet fjalë për shkelje të privatësisë.</p>
<p>...nuk keqtrajtoj, tall apo nënçmoj drejtpërdrejt një person, por pranoj shaka të destinuara për të dhe qesh, edhe kur personi është i pranishëm dhe shikon?</p>	<p>Ky është një shembull i bullizmit të kryer nga një grup njerëzish. Secili anëtar i grupit mund të ketë rol të ndryshëm, por gjithsesi kontribuon në bullizmin.</p>
<p>... në rrjetet sociale shpërndaj materiale që tallin ose nënçmojnë një person , edhe pse nuk e postoj?</p>	<p>Pavarësisht se kush e ka postuar fillimisht përmbajtjen specifike, duke e mbështetur dhe shpërndarë atë ti je duke bërë bullizëm.</p>
<p>...shmang personin që është përpjekur të raportoj se ishte viktimë e bullizmit?</p>	<p>Përrjashtimi është formë indirekte e bullizmit. Duke vepruar kështu, ti jo vetëm që mbështet dhunuesin, por gjithashtu kontribuon në statusin e bullizmit të viktimës.</p>

## **6. Ku mund të drejtohem për mbështetje dhe ndihmë në rast të bullizmit?**

Nëse mendon se je duke u bullizuar, hapi i parë që duhet të bësh është të kërkosh ndihmë nga dikush të cilit i beson, siç janë prindërit, ndonjë anëtar i ngushtë i familjes ose ndonjë i rritur tjetër të cilit i beson. Në shkollë mund të flasësh me psikologun ose mësuesin tënd të preferuar. Gjithashtu mund të kërkosh ndihmë dhe mbështetje nga organizatat që punojnë me të rinjtë. Nëse ngacmimi ndodh në platformë sociale, blloko abuzuesin dhe raporto zyrtarisht sjelljen e tij ose të saj në vetë platformën. Mund të jetë e dobishme të mblidhen prova - mesazhe me tekst dhe pamje nga ekranet e postimeve - për të treguar se çfarë ka ndodhur. Për të ndaluar bullizmin, gjëja kryesore është ta raportosh atë. Kjo do t'i tregojë dhunuesit se sjellja e tij është e papranueshme. Nëse je në rrezik të menjëhershëm, telefono policinë.

## **7. Çfarë mund të bëj nëse jam dëshmitar i bullizmit?**

Çdokush mund të bëhet viktimë e bullizmit. Nëse vëren se diçka e tillë i ndodh dikujt tjetër, përpiqu ta mbështetësh atë. Nëse viktimi ende nuk dëshiron të raportojë rastin, atëherë ndihmoje të gjejë një të rritur të besuar që mund ta ndihmojë që të përballet me situatën. Mos harro se në situata të caktuara pasojat e bullizmit mund të jenë kërcënuese për jetën.

### III. SI TË MBROHEM?

#### **Disa këshilla se si të mbrosh informacionin tënd personal:**

- 1.** Mbyll gjithmonë kompjuterin ose telefonin kur nuk është në përdorim.
- 2.** Përdorni fjalëkalim të fortë dhe të ndërlikuar për kompjuterin tënd dhe profilin e përdoruesit kudo në internet. Fjalëkalimi duhet të përbëhet nga një kombinim i karaktereve alfanumerike: shkronja (të mëdha dhe të vogla), simbole, numra dhe shenja pikësimi. Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë pjesë asnjë nga emri ose mbiemri yt ose ndonjë informacion në lidhje me ty. Mund të përdorsh frazë (poemë, varg, citim, libër, fakt i njohur) për një fjalëkalim.
- 3.** Kurrë mos ndaj fjalëkalimet me askënd! Mbaj mend ato dhe mos i mbaj në portofol ose në çantë.
- 4.** Gjithmonë përdor softuerin më të fundit në pajisjen tënde.
- 5.** Fshih skedarët e rëndësishëm.
- 6.** Çaktivizo shërbimet dhe proceset e panevojshme.
- 7.** Mos beso menjëherë çdo informacioni që do ta lexosh në internet. Kontrolllo me kujdes burimin e informacionit.
- 8.** Ki kujdes! Ka shumë predatorë në internet.

## **Çfarë mund të bësh për të reduktuar rrezikun e bullizmit në internet?**

- 1.** Bëje profilin tënd privat.
- 2.** Blloko dhe raporto dhunuesit dhe përmbajtjen që ata postojnë.
- 3.** Fto dhe prano vetëm miq të vërtetë.
- 4.** Mendo dy herë përpara se të postosh diçka.
- 5.** Krahaso situatën në internet me situatën e vërtetë, “ballë për ballë”.
- 6.** Mbaj për vete fjalëkalimet tua.



## Burime:

Udhëzuesi virtual i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Virtuale (DPO) në dispozicion në <https://www.dzlp.mk/e-tutorials/dpo/mk/story.html>

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/2020 dhe 294/2021).

UNICEF, bullizmi kibernetik: Çfarë është dhe si ta ndaloni atë, **10 gjërat që adoleshentët duan të dinë për bullizmin kibernetik**, në dispozicion në:

<https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/%D1%81%D0%B0%D1%98%D0%B1%D0%B5%D1%80-%D1%81%D0%B8%D0%BB%D0%B5%D1%9F%D0%B8%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE-%D1%88%D1%82%D0%BE-%D0%BFD1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%B2%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%B8-%D0%BA%D0%B0%D0%BA%D0%BE-%D0%B4%D0%B0-%D1%81%D0%B5-%D0%B7%D0%B0%D0%BF%D1%80%D0%B5>

Privatësia e fëmijëve dhe të rrinjëve në botën e teknologjive moderne, në dispozicion në:

[https://privacy.mk/sites/default/files/u4/privatnosta\\_na\\_decata\\_i\\_mladite\\_vo\\_svetot\\_na\\_moderni\\_tehnologii.pdf](https://privacy.mk/sites/default/files/u4/privatnosta_na_decata_i_mladite_vo_svetot_na_moderni_tehnologii.pdf)







MYLA

**Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj  
(ShMJR)**

rr. "Donbas" nr. 14/1-6

1000 Shkup

[www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk)

[contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk)